



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR MAT

VENDIM

Nr. 9 ,datë 21.05.2024

PËR

**KORRIGJIMIN E GABIMIT MATERIAL, KORRIGJIMIN E NIPT-it
NË LEJEN ME NR. SERIAL 000109 “PËR PËRDORIM BURIMI
UJOR NËNTOKËSOR”, SUBJEKTI “LEZHA KONSTRUKSION”
SHPK**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, si dhe referuar nenit 112, të Kodit të Procedurave Administrative “Korrigjimi i gabimeve materialeve në aktin administrativ” 1. Organi publik,në cdo kohë,kryesisht apo me kërkesë,mund të korigjojë gabimet e shkrimit,gabimet në përlllogaritje dhe pasaktësi të tjera të dukshme,në një akt administrativ.2.Organi publik ka të drejtë të kërkojë kthimin e aktit administrativ të shkruar që korigjohet,sidhe të cdo kopje të njëhsuar të tij. Në këto kushte: pasi u konstatua gabimi dhe pasaktësia është vendosur dukshëm si pasojë e gabimit material, Këshilli i Basenit Ujor Mat,

VENDOSI:

1. Korrigjimin e NIPT-it në “leje për përdorim burimi ujor nëntokësor dhënë me vendimin nr.1 datë 05.03.2024, subjekti “LEZHA KONTRUKSION” shpk nga **K92005016L** të bëhet **K48130527H**
2. Asnjë trgues tjetër nuk ndryshon përvec gabimit material (Nga NIPT-i **K92005016 L** të bëhet **K48130527H**)
3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

KRYETARI I KBU MAT

GJERGJ PRENDI

